VENDIM
Nr.254, datë 12.3.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS ZALL-HERR, TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Zall-Herr, të qarkut të Tiranës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Zall-Herr, të qarkut të Tiranës, miratuar me vendimin nr.915, datë 29.12.2007 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në komunën Zall-Herr, të qarkut të Tiranës".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Zall-Herr për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Zall-Herr — Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
1-10	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në zhvillim ekonomik.	Në pronësi
11-37 (vetëm troje)	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
11-37 (vetëm sheshet)	Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
38-50, 56-63	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e mbrojtjes civile.	Në pronësi
64-85	Varrezat publike	Në pronësi
87-91	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
51-55	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
110-132	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
287-323	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
324-427	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi

435-436	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi